



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI I SHQIPËRISË
KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT**

Tiranë, më 20.9.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR EUROBONDIN QË DO TË EMETOHET NGA MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE BLERJEN MBRAPSHT (BUYBACK) TË NJË PJESE TË EUROBONDIT EKZISTUES, MIRATIMIN E PËRJASHTIMEVE NGA TATIMET E TAKSAT DHE TË PARASHIKIMEVE PËR HEQJEN DORË NGA IMUNITETI NË MARRËVESHJET QË DO TË LIDHEN”

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 20 shtator 2018, shqyrtoi projektligjin “Për eurobondin që do të emetohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe blerjen mbrapsht (buyback) të një pjese të eurobondit ekzistues, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen”, propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit përgjegjës dhe sipas procedurave të parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhje ishte i pranishëm Ministri i Financave, i cili paraqiti projektligjin dhe dha sqarimet përkatëse për deputetët.

II. Përmbajtja e projektligjit.

Projektligji synon sigurimin e financimit të vendit tonë nga tregu ndërkombëtar, nëpërmjet instrumentit eurobond, i cili do të përdoret:

- për të plotësuar në mënyrë optimale nevojat për financim të viteve 2019 dhe 2020;
- për të mundësuar një menaxhim optimal të detyrimeve dhe instrumenteve të borxhit publik në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Instrumenti Eurobond është emetuar nga Ministria e Financave në këto faza:

- Eurobondi i parë është emetuar në nëntor 2010 me maturim deri në nëntor 2015. Ai kishte një vlerë prej 300 milionë eurosh, me një normë interesi 7.5 për qind.
- Eurobondi i dytë, i cili u emetua për të zëvendësuar eurobondin e parë, ishte në vlerën 450 milionë euro, me një normë interesi 5.75 për qind, me maturim deri në nëntor 2020.
- ***Eurobondi i tretë, që propozohet të emetohet sipas këtij projektligji, është në vlerën deri në 500 milionë euro, me afat maturimi 5-10 vjet.***

Emetimi i eurobondit, sipas këtij projektligji, do të shoqërohet me blerjen mbrapsht *buyback* të një pjese të eurobondit ekzistues. Nëpërmjet procedurës *buyback* do të tërhiqen para maturimit instrumentet ekzistuese, të cilat do të zëvendësohen me shumat e marra nga eurobondi i ri. Kjo procedurë është aplikuar edhe më parë në tregun ndërkombëtar. Gjithashtu, ajo është aplikuar edhe në tregun e brendshëm të titujve qeveritarë, në vitin 2015, pas daljes në tregun ndërkombëtar. Synimi i kësaj procedure është ulja e riskut të refinancimit, sidomos në vitin 2020, kur nevojat janë relativisht të larta (mbi 700 milionë euro). Parapagesa në vitin 2018, për instrumentin që maturohet në vitin 2020, siguron një kursim të mundshëm.

Procesi i emetimit të eurobondit ka kaluar në disa faza, siç janë:

- Ndryshimi i bazës ligjore të huamarrjes shtetërore, duke synuar rritjen e fleksibilitetit të huamarrjes me instrumente financiare dhe reduktimin e kostos së saj;
- Ndryshimi i ligjit të buxhetit, i cili mundëson fleksibilitet të niveleve të huamarrjes shtetërore, për të siguruar uljen e kostove;
- Përzgjedhja e rregulluesve kryesorë (Joint Lead Managers), të cilët do të drejtojnë procesin e emetimit të eurobondit. Këto banka janë Citi, Banca IMI, Societe Generale, me eksperiencë në tregjet e kapitalit dhe transaksionet financiare.
- Përzgjedhja e këshilltarit ligjor ndërkombëtar, që është Dechert LLP, konsulenti ligjor i vitit 2015.
- Organizimi i një sërë takimesh me bankat e institucionet ndërkombëtare, për t'u informuar mbi mundësitë dhe kushtet e emetimit të eurobondit në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2018.

Parashikimet e deritanishme të bankave ndërkombëtare, që kanë shprehur interes për realizimin e këtij transaksioni, janë që eurobondi të emetohet brenda muajit tetor 2018. Për këtë arsye, projektligji parashikon hyrjen në fuqi menjëherë.

Bazuar në vlerësimet e bankave ndërkombëtare, vendi ynë është në një pozicion më të favorshëm në vitin 2018 për emetimin e eurobondit në tregun ndërkombëtar. Kjo mbështetet në rezultatet e arritura, siç janë:

- Forcimi i konsolidimit fiskal, që shprehet nëpërmjet balancës primare pozitive dhe nivelit në rënie të borxhit publik;
- Përshpejtimi i rritjes ekonomike dhe pritshmëritë për një trend në rritje edhe gjatë periudhës afatmesme dhe afatgjatë;

- Rezultatet pozitive në menaxhimin e financave publike dhe pritshmëritë pozitive edhe për periudhën në vijim;
- Realizimi me sukses i reformave të planifikuara dhe pritshmëritë pozitive për periudhën në vijim;
- Progresi pozitiv në procesin e integritit në BE.

Projektligji ka efekte financiare, të cilat janë parashikuar që të përballohen nga buxheti i shtetit.

III. Vlerësimi i Komisionit.

Komisioni vlerëson se projektligji është me rëndësi të veçantë, pasi mundëson sigurimin e financimit të nevojshëm në treg dhe rrit fleksibilitetin e huamarrjes. Marrja e këtij financimi nuk cenon trajektoren e uljes së borxhit publik.

Dalja e vendit tonë në tregun ndërkombëtar favorizohet nga rezultatet pozitive të arritura në drejtim të konsolidimit fiskal, fleksibilitetin dhe qëndrueshmërinë e politikave monetare, stabilitetin e çmimeve dhe të kursit të këmbimit, si dhe vijimësinë e reformave strukturore.

Gjithashtu, ky projektligj do të ndihmojë në uljen e presionit në tregun e brendshëm dhe zgjerimin e hapësirave që ai ofron për financimin e veprimtarisë së biznesit, rritjen e investimeve, të punësimit e konsumit, pra edhe të ekonomisë në tërësi.

IV. Përfundim.

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORI

Anastas ANGJELI

KRYETARI

Erion BRAÇE